

VENDIM
Nr. 108, datë 13.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 37, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REPARTIT TË INSPEKTIM-
SHPËTIM-MINIERAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr. 8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 10 e vendimit nr. 37, datë 28.2.2002 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“10. Organika e Repartit të Inspektim-Shpëtim-Minierave (RISHM) të jetë sipas skemës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Vendimi nr. 760, datë 8.7.2009 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha